



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HASANI: S'E PËRJASHTOJ MUNDËSINË QË KUVENDI TË MOS KONSTITUOHET DHE KUSHTETUESJA TË VIHET SËRISH NË LËVIZJE

FAQE 4-5



Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, thotë se i takon politikës që, brenda normave dhe parimeve kushtetuese, të

gjejë rrugë për të dalë nga ngërçi politik. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Hasani thotë se nuk e përfshijë mundësinë që Kuvendi të

mos konstituohet brenda 30-ditësh dhe Gjykata Kushtetuese "të vihet sërish në lëvizje sipas procedurës së paraparë kushtetuese dhe ligjore"

OSMANI SËRISH THIRRJE PARTIVE POLITIKE: LINI ANASH DALLIMET F. 3



MIKROPLASTIKA EDHE NË IBËR: SI TË ULET RREZIKU? F. 2



AKTUALE



MINISTRI GJERMAN NË KIEV: UKRAINA MUND TË LLOGARISË NË MBËSHTETJEN E GJERMANISË F. 2

MBROJTJA E THAÇIT KËRKON HEQJEN E AKTAKUZËS PËR PENGIM TË DREJTËSISË F. 3

PROKURORIA KËRKON NJË MUAJ PARABURGIM PËR TË DYSHUARIN PËR SULM NDAJ PJESETARËVE TË KFOR-it F. 7

EKONOMI



ATK-ja BËN THIRRJE QË TË DEKLAROHEN DHE TË PAGUHEN TATIMET PËR TË ARDHURAT E REALIZUARA SI: 'FREELANCER', 'INFLUENCER', 'OUT-SOURCE' F. 8

DREJTORI I ATK-së VIZITON DEPARTAMENTIN TATIMOR RAJONAL NË PRIZREN 1 DHE 2 F. 8

SPORT



'YLLI I JAVËS' NË SUPERLIGË: PEFOELI: ÇMIMIN IA DEDIKOI BABAIT TË NDJERË F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ministri gjerman në Kiev: Ukraina mund të llogarisë në mbështetjen e Gjermanisë

KIEV, 25 GUSHT - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, duhet ta ketë të qartë se mbështetja e Gjermanisë për Ukrainën nuk po zbehet, tha të hënën ministri i Financave dhe zëvendëskancelari gjerman, Lars Klingbeil, pasi mbërriti në kryeqytetin ukrainas, Kiev, për një vizitë të paparalajmëruar. “Putini nuk duhet të ketë iluzione se mbështetja e Gjermanisë për Ukrainën mund të ndalet”, tha Klingbeil, kryetar i Partisë Socialdemokrate, e cila është partnere e vogël në koalicionin qeverisës të

udhëhequr nga kancelari Friedrich Merz. “Përkundrazi, ne mbetemi mbështetësi i dytë më i madh i Ukrainës në botë dhe më i madhi në Evropë”, theksoi Klingbeil. “Ukraina mund të vazhdojë të llogarisë në mbështetjen e Gjermanisë”, shtoi ai. Klingbeil i bëri thirrje Putinit të dëshmojë se është i interesuar për paqe në luftën më vdekjeprurëse në Evropë në 80 vjetët e fundit, e cila shpërtheu në shkurt të vitit 2022. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka

shtyrë për përfundimin e shpejtë të luftës, por Kiev dhe aleatët e tij shqetësohen se ai mund të përpiqet ta imponojë një marrëveshje sipas kushteve të Rusisë. Klingbeil tha se Ukraina duhet të përfshihet në bisedime dhe se janë të domosdoshme armëpushimi dhe garancitë e besueshme të sigurisë për të pasur paqe të qëndrueshme. “Për këtë qëllim, ne po bashkëpunojmë ngushtë në nivel ndërkombëtar”, u shpreh ai. Ndër opsionet e paraqitura këtë javë për sigurinë e Ukrainës pas



një marrëveshjeje të mundshme të paqes, si presidenti francez,

Emmanuel Macron, ashtu edhe kryeministri britanik, Keir Starmer, shprehën mbështetje për dërgimin e trupave si pjesë e një koalicioni të vullnetit. Merz gjithashtu ka treguar se Gjermania është e hapur për pjesëmarrje në këtë koalicion, por do të përballej me kundërshtime si nga brenda ashtu edhe nga jashtë spektrit të tij politik për këtë çështje. Sipas Ministrisë së Klingbeilit, Qeveria gjermane e ka mbështetur Ukrainën me 50.5 miliardë euro që nga fillimi i luftës.

Pesë gazetarë në mesin e 20 të vrarëve nga sulmet izraelite në Gazë



Gaza, 25 gusht- Agjencia e Gazës për Mbrojtje Civile ka thënë se pesë gazetarë janë në mesin e të paktën 20 personave të vrarë të hënën, si pasojë e sulmeve izraelite në një spital në jug të enklavës. Agjencitë Reuters, Associated Press dhe televizioni Al Jazeera kanë konfirmuar se në mesin e të vrarëve janë gazetarë që kanë kontribuar për këto medime. Zëdhënësi i agjencisë, Mahmud Bassal, ka thënë se “numri ka shkuar në 20 martirë, përfshirë pesë gazetarë dhe një pjesëtar të Mbrojtjes Civile”, pas sulmeve në spitalin Nasser në Han Junis- një kompleks i madh mjekësor në jug qe është shënjestruar disa herë nga Izraeli prej nisjes

së luftës. Sipas vëzhguesve të mediave, rreth 200 gazetarë janë vrarë përgjatë dy vjetëve të luftës mes Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi tjera. Ushtria izraelite ka konfirmuar se trupat e saj ushtarake kanë kryer sulme në zonën e spitalit në Han Junis. “Shefi i shtabit të përgjithshëm urdhëroi që të kryhet hetim fillestar sa më shpejt që është e mundur”, ka thënë ushtria përmes një deklarate, duke shtuar se “ndjen keqardhje për dëmet ndaj individëve të papërfshirë” dhe që “nuk i shënjestron gazetarët”. Spitali Nasser është ndër

qendrat e vetme shëndetësore në Rripin e Gazës që është të paktën pjesërisht funksional. Lufta në Gazë është nxitur nga sulmet e Hamasit në tokën izraelite, në tetor të vitit 2023, duke lënë të paktën 1.200 njerëz të vrarë, kryesisht civilë. Si pasojë e ofensivës izraelite janë vrarë të paktën 62.000 palestinezë, shumica prej tyre gra dhe fëmijë, sipas të dhënave të autoriteteve shëndetësore në Gazë. Organizata ndërkombëtare të ndihmës kanë ngritur alarmin për zi buke në Gazë, teksa shumica e hyrjeve për ndihma mbesin të bllokuara. Izraeli, në anën tjetër, i hedh poshtë këto vlerësime.

Vetoja e presidentit polak kërcënon qasjen e Ukrainës në Starlink

Varshavë, 25 gusht- Qasja e Ukrainës në shërbimin e internetit satelitor Starlink, mund të bllokohet për shkak të vetos së presidentit të Polonisë, Karol Nawrocki në një projektligj për ndihmë për refugjatët, ka bërë të ditur zëvendëskryeministri polak të hënën, teksa konflikti mes Qeverisë dhe kreut të shtetit sa shkon e thellohet. Polonia e paguan shërbimin e Starlinkut për Ukrainën, duke mundësuar shtrirjen e internetit në këtë shtet dhe në zonat ku janë të pociozonuara forcat ushtarake ukrainase, të cilat luftojnë pushtuesit rusë. Presidenti polak, Nawrocki i ka vënë veton projektligjit për vazhdim të ndihmës financiare për refugjatët ukrainas dhe i ka bërë të ditura planet për t’ua kufizuar atyre qasjen në kujdes shëndetësor dhe përfitime për fëmijë.

Megjithatë, zëvendëskryeministri polak, Krzysztof Gawkowski, ka thënë se legjislacioni përfshin edhe bazën ligjore për ofrim të Starlinkut në Ukrainë. “Këtu merr fund interneti nga Starlinku të cilin e paguan Polonia për Ukrainën, teksa përballet me luftë”, ka shkruar ai në X. Një zëdhënësi i Gawkowski ka thënë se vetoja e Nawrockit nënkupton se prej 1 tetorit nuk do të ketë bazë ligjore për t’i kryer pagesat për Starlink. Zëdhënësi i Nawrockit i ka thënë agjencisë së lajmeve Reuters se baza ligjore për Starlinkun mund të rikthehet nëse parlamenti e miraton një projektligj të propozuar nga presidenti deri në fund të muajit. Polonia është njëra prej mbështetëseve më të mëdha të Ukrainës, prej nisjes së pushtimit rus më 2022. Si Qeveria e qendrës, e

kryeministrit, Donald Tusk, ashtu edhe Nawrocki, nacionalist konservator, pajtohen për nevojën e ofrimit të ndihmës për Ukrainën që t’i bëjë ballë pushtimit rus, ndonëse disa polakë janë me dy mendje nëse duhet ofruar ndihmë për 1.5 milion ukrainasit që tani jetojnë në Poloni. Nawrocki ka bërë fushatë këtë vit me bindjen se “polakët duhet të jenë prioritet” dhe ka kërkuar që të kufizohen të drejtat e të huajve në Poloni. “Nuk e kam ndryshuar mendimin dhe synoj përmbytjen e obligimeve të mia, dhe besoj që ndihma duhet t’iu ofrohet vetëm ukrainasve që bëjnë përpjekje për të punuar në Poloni, dhe e njëjta gjë vlen edhe për kujdes shëndetësor”, u ka thënë ai gazetarëve. Ministria e Jashtme e Ukrainës nuk ka reaguar ndaj këtij vendimi.



Refugjatët ukrainas në Poloni kanë të drejtë t’i marrin 219 dollarë për një fëmijë, nëse fëmijët shkojnë në shkollat polake. Edhe vendet tjera të Bashkimit Evropian kanë propozuar së fundmi zvogëlimin e përfitimeve

për ukrainasit. Në Poloni, presidenti mund t’i propozojë projektligjet dhe të përdorë veton ndaj legjislacioneve qeveritare. Ngjashëm, edhe Qeveria mund t’i bllokojë propozimet e presidentit.

Osmani sërish thirrje partive politike: Lini anash dallimet

PRISHTINË, 25 GUSHT - Presidentja Vjosa Osmani, në një intervistë për transmetuesin polak TVP World në Alpbach, u bëri thirrje të gjithë partive politike për të bërë kompromis dhe për të arritur funksionalizimin e Kuvendit. Ajo thotë se është për të ardhur

keq që populli i Kosovës nuk ka ende të funksionalizuara institucionet. Sipas saj, mes partive politike ka mosbesim, dhe nuk kanë vullnet për të bashkëpunuar. “E shfrytëzoj rastin që t’u bëjë thirrje sërish të gjitha partive politike që

ta vendosin interesin e vendit para, e t’i lënë anash dallimet. Të tentojnë të formojnë një koalicion të shumicës parlamentare e cila e dërgon Kosovën para”, tha presidentja Osmani. E para e vendit shton se bota

është trazuar, dhe Kosova nuk mund të jetë në qendër të vëmendjes. “Nuk e kemi luksin të presim, duhet të veprojmë, jemi duke humbur shumë kohë”, thotë ndër të tjera ajo, lidhur me ngërçin politik të krijuar në vend.



MIKROPLASTIKA EDHE NË IBËR: SI TË ULET RREZIKU?

PRISHTINË, 25 GUSHT - Gotat, shishet dhe lugët plastike përdoren për pak minuta, por mbeten në tokë e ujë për qindra vjet. Ekspertët paralajmërojnë se mikroplastikat tashmë kanë depërtuar në zinxhirin ushqimor dhe në trupin e njeriut, duke e bërë urgjente gjetjen e alternativave. Në kafenetë, baret e restorantet e Kosovës, uji, limonada apo edhe akullorja shpesh shërbehen në shishe, gota e enë plastike, që përdoren vetëm për disa minuta dhe më pas përfundojnë në mbeturina.

Ky zakon i përditshëm, paralajmërojnë ekspertët, e ndot mjedisin për shekuj dhe rrezikon edhe shëndetin e njeriut. Për ta ndryshuar atë, Qendra Rajonale e Aktiviteteve e OKB-së MedWaves dhe Agjencia gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ ndërmorën këtë verë një nismë rajonale në Shqipëri, Bosnje e Hercegovinë, Kosovë e Mal të Zi, të quajtur “Zona me pak plastikë”. Në një përgjigje për “Radion Evropa e Lirë”, GIZ-i shpjegon se iniciativa është në përputhje me Direktivën e Komisionit Evropian (2019/904) për reduktimin e ndikimit të disa produkteve plastike në mjedis, e miratuar në qershor të vitit 2019.

Qëllimi, sipas deklaratës, është “të parandalojë dhe reduktojë ndikimin e disa produkteve plastike në mjedis, veçanërisht në mjedisin ujor dhe në shëndetin e njeriut, si dhe të nxisë kalimin drejt një ekonomie qarkore me modele biznesi, produkte dhe materiale inovative e të qëndrueshme”. Në Kosovë, projekti zbatohet nga Oda Ekonomike e Kosovës, e cila synon t’i bindë bizneset e gastronomisë që të heqin dorë nga plastika njëpërdorimëshe. Njëri nga të parët që iu përgjigj thirrjes është Astir Gllareva, pronar i restorantit “Albanezi”. “Me dëshirë i jam bashkuar iniciativës. Brenda në lokal nuk shërbejmë më me produkte të plastikës, madje edhe lugët e kafesë i kemi hequr. E vetmja plastikë që përdoret, janë tasat e kafesë që klientët i marrin me vete në mëngjes. Nëse gjendet alternativë, do t’i heqim edhe ato”, thotë Gllareva për “Radion Evropa e Lirë”, duke shtuar se është i gatshëm të largojë çdo produkt që ndot mjedisin. “REL”-i kontaktoi edhe disa pronarë të tjerë lokale ku ende përdoren produkte plastike njëpërdorimëshe, por asnjëri prej tyre nuk pranoi të fliste publikisht - megjithatë, shumica thanë se janë të gatshëm të



reduktojnë përdorimin e tyre. Sfida e menaxhimit të mbeturinave plastike është e madhe, thotë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, i cili nismën e konsideron si të domosdoshme. Ai thotë se interesimi i bizneseve është i lartë, me mbi 250 kompani që tashmë e kanë mbështetur projektin. Në sektorin e gastronomisë dhe akomodimit në Kosovë veprojnë rreth 8.000 biznese. Produktet plastike, paralajmërojnë ambientalistët, janë ndër ndotësit më të mëdhenj, pasi shndërrohen në mikroplastikë dhe mbeten për

shekuj në mjedis, duke kërcënuar botën e gjallë dhe shëndetin e njeriut. Aktivistja mjedisore, Egzona Shala-Kadiu, thekson se gastronomia është një nga sektorët që prodhon më së shumti mbetje plastike, ndaj reduktimi i tyre është i domosdoshëm. “Plastika është material shumë rezistent dhe përbërja e saj kimike bën që të mbetet në mjedis për qindra vite”, thotë ajo për Radion Evropa e Lirë. Në ueb-faqen e MedWaves thuhet se plastika ka jetëgjatësi alarmante: një qese shpërbëhet pas rreth 20 vjetësh, një shkop

për pije pas 200 vjetësh, një shishe plastike pas 450 vjetësh, ndërsa enët plastike mund të qëndrojnë deri në 1000 vjet. Në nivel global përdoren çdo vit rreth 500 miliardë gota plastike dhe çdo ditë afro 500 mijë shkopinj për pije.

Duke qëndruar për caq kohë në mjedis, Shala-Kadiu thotë se mikroplastikat përfundojnë në ujëra dhe ushqime, duke u konsumuar nga qytetarët pa e ditur.

Mikroplastikat janë copa mbeturinash plastike nën pesë milimetra gjatësi, shpjegon Shërbimi Kombëtar i Oqeanit i ShBA-së (NOAA).

Disa, si mikroperlat, që zakonisht gjenden në kozmetikë dhe produkte higjienike, janë krijuar të jenë të vogla, ndërsa plastika tjetër shpërbëhet gradualisht deri në këtë madhësi.

Edhe pse mikroperlat janë të ndaluara tani në shumë vende, problemi i ndotjes plastike është ende larg zgjidhjes.

Sipas NOAA-së, çdo vit deri në 23 milionë tonë mbeturina plastike përfundojnë në sistemet ujore të botës.

Ato, shpesh, janë aq të vogla saqë kalojnë nëpër sistemet e filtrimit të ujit dhe mund të gëlltiten pa e ditur.

MBROJTJA E THAÇIT KËRKON HEQJEN E AKTAKUZËS PËR PENGIM TË DREJTËSISË



PRISHTINË, 25 GUSHT - Mbrojtja e ish-presidentit Hashim Thaçi, ka dorëzuar më 18 gusht 2025 një kërkesë ndaj vendimit të Gjykatës Speciale lidhur me kompetencën për të shqyrtuar Rastin 12, që lidhet me akuzën për pengim të drejtësisë. Në këtë kërkesë, mbrojtja e Thaçit kërkon nga paneli i Apelit që të anulojë vendimin e Gjykatës dhe të deklarojë se

gjykatësi paraparak nuk ka qenë kompetent për të nxjerrë aktakuzën për Rastin 12, raporton “Betimi për Drejtësi”. Mbrojtja argumenton se Prokuroria Speciale ka filluar procedurat në mënyrë të njëanshme para një gjykatësi të vetëm, duke anashkaluar kompetencat ekskluzive të Panelit të Gjyqtarëve që duhet të mbikëqyrë çështjet që lidhen

me gjykimin e drejtë të Thaçit. Ekipi mbrojtës argumenton se trajtimi i të njëjtave fakte në dy procese të ndryshme rrezikon vendime kontradiktore dhe cenon prezumimin e pafajësisë së ish-presidentit. Gjykatësi më 19 qershor 2025, kishte refuzuar plotësisht kërkesën e mbrojtjes për moskompetencë, por më pas mbrojtja ka kërkuar leje për

kërkesë duke identifikuar katër çështje për shqyrtim dhe certifikim, nga të cilat tri janë miratuar më 23 korrik 2025. Avokatja Sophie Menegon, që e përfaqëson Thaçin ka kërkuar që të hiqet aktakuza e Rastit 12 dhe të shpallë se gjyqtari i procedurës paraprake nuk kishte kompetent për të lëshuar aktakuzën mbi këtë rast.

Limaj me uniformë të veteranit bën homazhe për nder të Ditës së Dëshmorëve të Brigadës 121 Ismet Jashari - Kumanova

MALISHEVË, 25 GUSHT - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, së bashku me familjarë të dëshmorëve, bashkëlufëtardë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe bashkëpunëtorë, shënuan Ditën e Dëshmorëve të Brigadës 121 Ismet Jashari -

Kumanova në Kleçkë. “Kjo datë më vlerë është vendtakim i të gjallëve me shokët që kanë rënë dhe familjarët e tyre për të kujtuar veprën e tyre, krenarinë e sakrificën që kanë bërë ushtarët e kësaj brigade. 25 gushti është përmbledhje e

gjithë asaj trimërie, sakrifice, lavdie e dhimbje që kanë përjetuar malet e Berishës nën këtë brigadë gjatë luftës së UÇK-së. Lavdi dëshmorëve të Brigadës 121 Ismet Jashari - Kumanova dhe gjithë dëshmorëve të kombit!”, ka theksuar Limaj.





HASANI: S'E PËRJASHTOJ MUNDËSINË QË KUVENDI TË MOS KONSTITUOHET DHE KUSHTETUESJA TË VIHET SËRISH NË LËVIZJE

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, thotë se i takon politikës që, brenda normave dhe parimeve kushtetuese, të gjejë rrugë për të dalë nga ngërçi politik. Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, Hasani thotë se nuk e përjashton mundësinë që Kuvendi të mos konstituohet brenda 30-ditësh dhe Gjykata Kushtetuese “të vihet sërish në lëvizje sipas procedurës së paraparë kushtetuese dhe ligjore”

PRISHTINË, 25 GUSHT- Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, thotë se i takon politikës që, brenda normave dhe parimeve kushtetuese, të gjejë rrugë për të dalë nga ngërçi politik. Në këtë intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, Hasani thotë se nuk e përjashton mundësinë që Kuvendi të mos konstituohet brenda 30-ditësh dhe Gjykata Kushtetuese “të vihet sërish në lëvizje sipas procedurës së paraparë kushtetuese dhe ligjore”. Sipas Hasanit, i cili është profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, aktgjykimi i fundit i Kushtetueses

lidhur me konstituimin e Kuvendit është i qartë, por shton se bazuar në sjelljen e Lëvizjes Vetëvendosje, afati 30-ditor i vendosur nuk do të respektohet. “Nëse gjykojmë sjelljet e zotit [kreut të LV-së, Albin] Kurti, gjendja po shkon drejt moskonstituimit të Kuvendit të Kosovës. Ai po zbaton aktgjykimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese me qëllim të pengimit të konstituimit ose inaugurimit të Kuvendit të Kosovës”, thotë ai. Hasani vlerëson se e vetmja mangësi e aktgjykimit të Kushtetueses është që aty nuk qartësohet sanksioni kushtetues. Si sanksion të mundshëm ai

përmend decertifikimin e kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, ose kur të identifikohen rastet e shkelësve të vendimeve të Kushtetueses, ata sipas tij, duhet të “eliminohen nga pozitat drejtuese, në këtë rast, në procesin e konstituimit”. Aktgjykimi i Kushtetueses - i publikuar i plotë më 18 gusht - u jep 30 ditë kohë deputetëve të përmbyllin procesin e konstituimit. Aty thuhet se kryeparlamentari zgjidhet me votim të hapur dhe emri i një kandidati mund të hidhet në votim deri në tri herë.

Profesor Hasani, a kanë shkaktuar paqartësi vendimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë të bëjnë me çështjen e konstituimit të Kuvendit të Kosovës?

Enver Hasani: Jo, askund nuk mund të fajësohet Gjykata Kushtetuese për paqartësi. Si ky aktgjykim, ashtu edhe ai i qershorit, janë të qartë. Problemi ka lindur dhe lind gjithmonë në terrenin politik. Kështu ka qenë edhe në të kaluarën. Dispozitat kushtetuese kanë qenë dhe mbeten të qarta, duke bërë

dallim mes konstituimit (inaugurimit) të Kuvendit të Kosovës dhe punës së Kuvendit të Kosovës pas konstituimit, si organ kushtetutvënës, ligjvënës, mbikëqyrës, deliberativ dhe përfaqësues i popullit të Kosovës dhe i qytetarëve të saj. Konstituimi është inaugurimi i Kuvendit të Kosovës pas certifikimit të zgjedhjeve nacionale, ashtu siç e ka sqaruar Gjykata Kushtetuese në vitin 2014. Në këtë inaugurim solemn nuk mund të ketë grup tjetër parlamentar përveç atyre që dalin nga vullneti i lirë dhe kutitë e votimit. Vetëm pas inaugurimit mund të vijë deri te reformimi dhe rformatizimi i grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Megjithatë, edhe atëherë, ai rikonfigurim dhe rformatizim nuk mund të ndryshojë strukturën e organeve të Kuvendit të Kosovës dhe as ato që lidhen me punën e tij. Për këtë ekzistojnë aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese që nuk lejojnë ndryshimin e kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe të strukturës së Komisionit Qendror Zgjedhor si pasojë e fluktuimeve partiake që ndodhin natyrshëm

në Kuvend dhe në terrenin politik. Çdo qasje ndryshe do ta zhvlerësonte kuptimin e zgjedhjeve nacionale. Interpretimet ndryshe që janë bërë dhe i bëhen këtij dimensionit - pra inaugurimit të Kuvendit të Kosovës dhe natyrës së tij juridiko-kushtetuese - janë dashakeqe dhe vijnë nga njerëz që nuk kanë njohuri themelore për të drejtën kushtetuese dhe të drejtën parlamentare si pjesë e saj. Në këtë dashakeqësi, jo rrallë shohim shfaqje të çoroditura nga individë që dikur kanë qenë militantë të një partie, ndërsa sot janë kundër së njëjtës parti. Kushtetuta, megjithatë, mbetet e njëjtë dhe nuk ka ndryshuar asgjë në konceptimin e inaugurimit të Kuvendit të Kosovës: ai duhet të bëhet patjetër, dhe mosinaugurimi i tij nuk mund të çojë në zgjedhje të jashtëzakonshme të përgjithshme. Kjo është përgjegjësi e grupeve parlamentare, ashtu siç kanë dalë nga kutitë e votimit, dhe asnjëherë ndryshe. Partia e parë fituese, që është gjithmonë fituese relative, sikurse edhe në vitin 2021, ka vetëm një

privilegj: t'i prijë procesit në mënyrën e përcaktuar nga Kushtetuta dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, ashtu siç interpretojnë ato nenet 66.1 dhe 67 të Kushtetutës dhe dispozitat relevante ligjore e nënligjore mbi inaugurimin e Kuvendit të Kosovës.

Vendimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese a ofron saktësi për zhbllokimin e procesit të konstituimit të Kuvendit?

Enver Hasani: Po. Aktgjykimi i fundit, pa asnjë dyshim, ofron saktësi për zhbllokimin e procesit të inaugurimit të Kuvendit të Kosovës. Partia e parë, ose koalicioni fitues i zgjedhjeve të shkurtit 2025, ka prerogativën kushtetuese për të propozuar kandidatin për kryetar të Kuvendit. Me këtë prerogativë vjen edhe përgjegjësia, që nënkupton se e drejta e dhënë kushtetuese nuk mund të abuzohet pafundësisht, sepse tashmë ekziston një afat 30-ditor brenda të cilit kjo e drejtë duhet të ushtrohet. Përveç kësaj, aktgjykimi i fundit ka treguar qartë edhe mënyrën e inaugurimit, duke e kufizuar të drejtën e propozimit të një kandidati vetëm në tri herë.

Çka i mungon vendimit të Kushtetueses?

Enver Hasani: Mendoj se i mungon qartësimi i sanksionit kushtetues. Në arsyetimin e saj, Gjykata, me stil të qartë profesional dhe elokuencë, ka treguar se Kushtetuta e Kosovës mund të shkelet edhe nga individë apo subjekte të tjera, të cilat më parë nuk kanë figuruar shprehimisht në tekstin e saj. Siç e dimë, deri më tani shkelje të tilla, me pasoja të qarta juridike, mund të ndodhnin vetëm nga presidenti i Republikës. Për këtë ekziston një praktikë e pasur gjyqësore, e cila prej kohësh studiohet dhe mësohet në katedrat e së drejtës kushtetuese në Kosovë dhe jashtë saj,

përveçse është trajtuar gjerësisht edhe në literaturën akademike. Meqë Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar mendimeve të Komisionit të Venecias, ka vënë në dukje se edhe individët mund të jenë shkelës të Kushtetutës në mënyrë autonome gjatë ushtrimit të detyrimeve të tyre kushtetuese dhe ligjore, atëherë është dashur dhe duhet të ndërtohen sanksione të qarta kushtetuese për shkelësit e tillë. Këto sanksione janë gjithmonë të ndryshme nga ato që shqiptohen në sferën penale, civile apo administrative.

E theksoj këtë sepse, për fat të keq, vazhdimisht ka njerëz që, në emër të profesionit, kërkojnë burgosjen e deputetëve për shkak të sjelljeve të tyre në procesin e inaugurimit të Kuvendit të Kosovës. Në këtë kuptim, asnjëherë nuk mund të ndodhë burgosja e deputetëve të Kosovës për shkak të moskonstituimit të Kuvendit. Përgjegjësia penale e deputetëve lind vetëm nëse ata shkelin ligjin penal, e jo Kushtetutën e Kosovës. Kaq e thjeshtë është kjo.

Profesor, çfarë mund të jenë ato sanksione?

Enver Hasani: Po, sanksionet mund të jenë, ta zëmë, që krejt natyrshëm do t'i shkonte zotit (kryesuesit të seancës konstituive Avni) Dehari decertifikimi i tij dhe jo vetëm largimi nga posti i kryesuesit për shkak të moshës. Ose, kur mund të identifikohen rastet e shkelësve (të vendimeve të Kushtetueses), të eliminohen nga pozitat drejtuese, në këtë rast, në procesin e konstituimit.

A po i shmangë Kushtetuesja në vendimet e saj të fundit pasojat ndaj shkelësve të vendimeve të saj?

Enver Hasani: Sigurisht që deri më tani Gjykata Kushtetuese ka vepruar me një lloj ndrojtjeje dhe është mbështetur shumë në mirëbesimin e deputetëve për zbatimin e aktgjykimeve të saj.

Pra, arsyeja pse Gjykata nuk po i vë në dukje pasojat juridiko-kushtetuese për individët që në mënyrë specifike pengojnë dhe rrënojnë procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës lidhet, nga njëra anë, me frikën nga politika dhe reagimet e saj irracionale, dhe nga ana tjetër me mbështetjen në mirëbesimin e deputetëve se do t'i zbatojnë detyrimet e tyre kushtetuese të përcaktuara në aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese.

Profesor Hasani, e përmendët që Gjykata Kushtetuese ka vepruar me një lloj ndrojtjeje. Nga kush druhet gjykata?

Enver Hasani: Partia në pushtet - nëse merret parasysh arkivi ose rekordi i krejt partive politike në raport me institucionet e drejtësisë, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, ose mbi të gjitha, Gjykatën Kushtetuese - besoj që Lëvizja Vetëvendosje ka një rekord absolut, dhe brutaliteti me të cilin ajo ka ftuar për linç ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është i pashembullt në jurisprudencën, jo vetëm të Kosovës, por edhe të vendeve të rajonit. Do të thosha se janë raste të rralla në praktikën e ish-vendeve komuniste. Mund të krahasohet me Bjellorusinë, me rastin e Gjykatës Kushtetuese në Rusi. Në të tjerat, nuk mund të hasim në këso (situatash) që me kaq brutalitet, me goditje kaq brutale, me ftesë për linçim në mënyrë kaq primitive, siç shohim te Lëvizja Vetëvendosje. Tentime të tilla ka pasur edhe në vitin 2014 ndaj meje personalisht, ndaj personit tim, dhe ndaj Gjykatës Kushtetuese, por zbatimi i tyre nuk ka shkuar me kaq vështirësi dhe me kaq komentime tërësisht joprofesionale.

Ku çon kjo shmangie e pasojave nga Gjykata Kushtetuese?

Enver Hasani: Kjo shmangie çon në thellimin e ngërçit politik aktual, duke e bërë edhe më të vështirë zgjidhjen e tij - zgjidhje

që është e pashmangshme, sepse asnjëherë individi, sado i fuqishëm politikisht, nuk mund të fitojë betejën me normat dhe parimet kushtetuese e ligjore dhe me mekanizmat shtetërorë që garantojnë zbatimin e tyre. Asnjëherë.

Presidentja Vjosa Osmani e ka tërhequr kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese për pasojat juridike për mosrespektimin e afrit 30-ditësh për konstituimin e Kuvendit. Pavarësisht kësaj, a mund të pritet që Gjykata Kushtetuese ta japë një mendim dhe a mund të ndodhë kjo para se të kalojë afati aktual prej 30 ditësh, që përfundon më 18 shtator?

Enver Hasani: Kërkesa e zonjës Osmani ka qenë turpi më i madh që mund të bëjë një shef shteti. Ajo ka pasur vetëm një qëllim: paralizimin e punës së Gjykatës Kushtetuese, në vend se të kujdesej për mirëvajtjen e saj, siç e ka detyrim kushtetues.

Edhe sikur zonja Osmani të ketë pasur informata të sakta për rrezikim të sigurisë kombëtare nga një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ajo nuk ka guxuar dhe nuk guxon të dalë në publik e të denoncojë një gjë të tillë. Si shefe e shtetit, ajo ka në dispozicion të gjitha mekanizmat kushtetues dhe shtetërorë për të nisur procedurat e nevojshme dhe për të penguar çdo rrezikim të sigurisë kombëtare. Thirrja me emër e mbiemër e një gjyqtari kushtetues nga presidentja e Republikës, në një çështje ku vetë është palë në procedurë, përbën asgjë më pak se huliganizëm institucional, i papranueshëm për çdo institucion shtetëror - e aq më pak për presidentin e Republikës.

Kjo kërkesë është qartazi e pabazuar dhe pa meritë. Gjykata, megjithatë, ka të drejtë të vazhdojë procedurën lidhur me të. Por, kjo kërkesë nuk ka asnjë relevancë në procedurat që lidhen me konstituimin e

Kuvendit të Kosovës, sepse presidenti i Republikës nuk mund të paraqitet si palë në procedurë për këtë temë. Presidenti i Republikës ka vetëm një autorizim: thirrjen e seancës së parë konstituive dhe edhe këtë jo si detyrim, por si kompetencë që mund ta ushtrojë nëse dëshiron.

A mendoni që Gjykata Kushtetuese sërish do të ballafaqohet me kërkesa për interpretim të gjendjes së krijuar lidhur me konstituimin e Kuvendit?

Enver Hasani: Nëse gjykojmë sjelljet e zotit Kurti, gjendja po shkon drejt moskonstituimit të Kuvendit të Kosovës. Ai po zbaton aktgjykimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese me qëllim të pengimit të konstituimit ose inaugurimit të Kuvendit të Kosovës.

Profesor, kur them se a mund të ketë kërkesa për interpretim të gjendjes së krijuar lidhur me konstituimin e Kuvendit, do të thotë a mund të ketë kërkesa të reja po themi, pasi eventualisht të përfundojë afati 30-ditor dhe çfarë mund të jenë ato?

Enver Hasani: Zgjidhja ka qenë dhe mbetet politike. I takon politikës të gjejë rrugëzgjidhje brenda normave dhe parimeve kushtetuese, si dhe aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese që interpretojnë këto norma dhe parime.

Nuk e përjashtoj mundësinë që Kuvendi i Kosovës të mos inaugurohet edhe brenda këtyre 30 ditëve të parashikuara, dhe që Gjykata të vihet sërish në lëvizje sipas procedurës së paraparë kushtetuese dhe ligjore.

Do të thotë, kjo është shtegdalja?

Enver Hasani: Po, nuk ka tjetër rrugë. Rruga e vetme është që procesi politik duhet të zhvillohet sipas normave dhe parimeve kushtetuese, ashtu siç i ka interpretuar dhe i interpreton Gjykata Kushtetuese. Asnjë rrugë tjetër nuk mund të ndiqet.



ADOLESHENTËT E POLITIKËS!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Anesteziologët dhe “politikanët”: Kosova si asnjëherë më parë është stërm bushur me politikanë që nuk e kanë kaluar moshën e pjekurisë politike duke mbijetuar politikisht ndonjë pavarësisht moshës së madhe kanë mbetur adoleshentë të papjekur dhe të verbuar prej egos së të qenit të mençur, të respektuar, të pazëvendësueshëm sipas automatizmit, jo të dijes por të postit që, në të shumtën e rasteve e kanë të pamerituar apo të blerë në këmbim të një servilizmi dhe dëgjueshmërie. Nëse pyetni se cila është pika përbashkuese e një anestiologu dhe një politikani në Kosovë, përgjigja do të ishte kjo. Një anestiolog me integritet profesional dhe moral përveç që ua zbutë thuaja deri në mohim dhimbjet pacientëve gjatë lëndimeve të rënda dhe operacioneve, me saktësinë e dhënies së dozës mund ta shpëtojë jetën duke e rikthyer pas një gjumi. Në të kundërtën, mund të shkaktojë dëme të mëdha deri të humbja e jetës. Një politikan me integritet profesional dhe moral i përmbushë premtimet zgjedhore duke ua lehtësuar jetën votuesve - qytetarëve për aq sa është në mundësinë e tij. Një adoleshent politik, nuk lidhet domosdoshmërisht me moshën, e bënë të kundërtën; në mungesë të integritetit profesional dhe moral, për t'i ikur përgjegjësisë, nuk qeverisë por sundon, nuk zhvillon por prapakthen, rrenën e konsideron të vërtetë, premtimin publik e shndërron në mashtrim publik kurse moralin e përkthen në prostitucion. Kosova kurrënjëherë nuk ka pasur nevojë më shumë për anesteziologë profesionistë dhe politikanë me virtyte por këta janë shumë të rrallë, nuk i gjen as ne teleskop. Të shëtisim pak nëpër foshnjoren e adoleshentëve politike në Kosovë.

1. PDK-ja: Pasi u fitua përshtypja se kishte hyrë në fazën e

pjekurisë politike sidomos pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, më 24 gusht të këtij viti dëshmoi se ishte një mashtrim optik, një fatamorganë në shkretëtirën politike të quajtur Kosovë. Si dëshmi e pjekurisë politike ishte zotimi publik se do ta votojë kandidatin e VV-së për kryetar Kuvendi nëse nuk ka qenë pjesë e kabinetit qeveritar Kurthi 2. Për këtë nuk e votuan marionetën numër 2, Lenka Haxhiu, urrjetësen patologjike të UÇK-së, të burgosurve politike dhe Bacë Adem Demaçi, shpirtzezën Donika Shvarc, antikombëtarin dhe njeriun e keq, Teneqe Muratin dhe ministren analfabete Pambuke Nagavcin. Deri këtu ishin në kuadër të përmbushjes së zotimit publik. Me 24 gusht 2025 doli si propozim emri i Dimal Bashës, këtij të padituri enciklopedik që nuk ishte pjesë e kabinetit qeveritar nëse nuk llogaritet roli i tij prej argëtuesit të oborrit sundues të diktatorit Kurthi. Dimali ishte original në karagjozllëkun e tij por se jam i bindur se nuk është as përsëafërmi shpirtzi sikur të lartpërmendurit. Se është leshko, nuk ka dyshim por se është leshko simpatik, gjithashtu nuk ka dyshim! Në rrethana të një mjedisi normal politik, nuk do të zgjidhej as kryetar i Kuvendit të Hajkobillës, në rrethana ku mbizotërojnë injorantët politikë vlen ajo e Azem Galicës se: “më m.t nuk bëhet.”, prandaj është dashur menjëherë ta votojnë Bashën e jo të kërkojnë 10 minuta për konsultim. Për çfarë konsultimi? Për të diskutuar për zotim publik para se të votojnë! 10-minutshi ka shërbyer që marioneta numër 1, Avni Dehari përmes refuzimit për konsultim, e pamundësoi konstituimin e Kuvendit duke i mprehur shpatën Kurthit që t'i presë kokat e opozitës. Dhe ashtu ndodhi; PDK-ja ra në gropën e zotimit publik që e shkeli duke e rikthyer në grupin e adoleshentëve politike. Tash, jo VV-ja por PDK-ja po merret si bllokuese ndonjë VV-ja, as dje,

as sot e as nesër nuk ishte e interesuar të formojë institucionet ndonjë Kurthi më 9 shkurt 2025 thoshte se i kanë votat edhe për Kuvend sikur edhe për qeveri. Ishte një pohim publik i rremë, e ardhmja e vërtetoi këtë. Jam shumë i sigurt se edhe nëse PDK-ja do ta votonte Bashën për kryetar Kuvendi, Albin Kurthi dhe VV-ja nuk do të votonin kryetarët e opozitës duke e mbajtur vendin në një ngërc institucional. Përgjegjësia për bllokim do ta kishte adresën e VV-së, tani e ka të PDK-së. PDK-ja e humbi mundësinë për ta fituar një epërsi politike që do të përkthehej me rritje të votave në zgjedhjet e ardhshme lokale dhe të përgjithshme, kurdo që ato të mbahen. PDK-ja në lojën e shahut ka dështuar duke rënë në kurthin e Kurthit përmes marionetës numër 1, Avni Dehari i cili ia ka humbur kuptimin dinjitetit dhe nderit, edhe si marionetë. Tash Kurthi i rikandidon, deri në tre herë dështakët e qeverisë, derisa të ketë nevojë.

1. PDK-ja u tregua se është në fazën e patejkaluar të adoleshencës politike edhe me rastin e eliminimit politik për kryetar të Drenasit, Ramiz Lladrovci ndonjë ishte shpallur, bashkë me Smajl Latifin e AAK-së kryetari më i suksesshëm dhe më transparent në Kosovë, sipas vlerësimeve vendore dhe ndërkombëtare. Kësaj i thonë: “rrëzo shtëpi e ndërto hajat.” Ramiz Lladrovci do ta dëmtojë PDK-në për së paku 25 mijë vota, sidomos në zgjedhje të përgjithshme.

2. Si shprehje e adoleshencës politike e PDK-së është lënia e deputetes Sala Jashari në rolin e “bashkëkryesueses” e që shpërfillet pamëshirshëm dhe paturpësisht nga marioneta numër 1, shkelës recidivist i Kushtetutës së Kosovës. Shëndeti i saj mendor duhet të mbrohet duke e tërhequr nga ajo pozitë që është uzurpuar nga marioneta numër 1.

2. LDK-ja: Është treguar më

korrektja dhe më konsistenja në mbrojtje të zotimit publik. Deklaruan se nuk e votojnë asnjë kandidat të VV-së pa një marrëveshje politike. Dhe nuk e votuan, mbrojtën parimin dhe moralin politik. Prandaj parashoh se do të kenë rritje, edhe në zgjedhjet lokale sikur ato të përgjithshme. E kuptuan drejt dhe shpejtë propozimin e Kurthit për koalicion, si një kurth kurthiane me qëllim të dobësimit dhe shndërrimit të LDK-së në parti siç mendermethënë janë GUXO dhe Alternativa e zemlakes Kusari. Vota e Arben Gashit për Dimal Bashën ka burimin në Kanunin e Lekë Dukagjinit - mbajtja e besës së dhënë e jo ndonjë përkrahje politike për shkak të korrektësisë. Arbeni e kishte të qartë se Basha nuk ka gjasa të kalojë prandaj ia mbajti zhagun, Arbeni votoi, Dimali nuk kaloi!

3. AAK-ja: Që nga fillimi propozoi dy emra nga VV-ja për kryetare të Kuvendit, Saranda Bogujevcin dhe Shqipe Selimin, sikur që ato të ishin anëtare të AAK-së e jo të VV-së. Deri këtu shkon adoleshenca politike. Ndërkaq, që të dyja e refuzuan nominimin nga AAK-ja duke thënë se e kanë Lenka Haxhiun, si antivlerë e pazëvendësueshme. Prandaj nuk e meritojnë këtë post. Duke ditur se nuk i siguron votat Basha për kryetar edhe me votën e Bekës, Berisha vazhdoi të luaj k.e me të gjithë të propozuarit e VV-së. Me Dimalin, më së paku.

1. Kur kanë thënë se nuk kanë vota për VV-në pa Fatmir Limajn kryetar Kuvendi, është menduar se i kanë vënë një çmim lëkurës politike dhe se pranojnë çdo gjë që ndërlidhet me grazhdin qeveritar. Deri më tani nuk del të jetë e vërtetë, NISMA nuk pranon t'i veshë brekët e ndyra qeveritare të dhjesura nga Kurthi dhe ministrat e tij. Nuk e votuan as Dimalin, drejtorin artistik të Festivalit të Gjysheve në Ferizaj, ngjarje kulturore aq e nevojshme në Kosovë, Evropë, Amerikë, Afrikë, Azi, Oqeani,

Kanada dhe Australi.

4. VV-ja: Deri më tani përkryer po e luan lojën e mashtrimit dhe shtetshkatërrimit. Në emër të patriotizmit dhe bashkimit kombëtar. Bashkim kombëtar, me kënd, me Shqipërinë sigurisht se jo. Patriotizmin e ka lënë peng të antikombëtarëve si Teneqe Murati, Mata Hari e Greqisë dhe Serbisë - Dejona Mihali, Mimoza Zemlake Kulari, Haxhi Qamili i Prizrenit, “Boletin” Pecit, Thaç Spasiqi i Obiliqit, Donikë Shvarczeza, komandantët dezertorë, Cen Mishi dhe Lal Culla, Psikopat Leshi, Vejusha e Panxhabit dhe të tjerë, sipas rendit alfabetik dhe përcaktimit kombëtar dhe politik. Zi e më zi, sikur që Besnik rrenci po lufton për shqiptarë në Serbi.

Janë disa gjëra që nuk i ha as qeni i Mahmutoviqe.

1. Haxhi Qamili, delikuent seksual del me një zhvillim epokal të paimagjinueshëm edhe për inteligjencën artificiale se: “Shqipe Selimi nuk është me Listën Serbe...”. Çfarë idioti!!!

Limoza Kulari, e përkëdhelura e të gjitha qeverive dhe regjimeve (të Gadafit dhe të Kurthit), shumë bujare me Radoiçiqin që e ka edhe zemlak, edhe brat (vëllaçko), tregon si opozita po bashkëvepron me Listën Serbe. E gërditshme, më së paku, edhe nga kjo mercenare! Dhe të tjerët me radhë, thuaja të gjithë! Jo klonë por klouna të Kurthit.

A ka gjë më të ndyrë se manipulimi me patriotizëm të refuzimit të certifikimit të Listës Serbe për zgjedhje lokale. U refuzua edhe Antonijeviqi por u lejua Atiqi.

Në VV nuk ka patriotizëm, nuk kishte kurrë përveç se u përdorë, bashkë me flamurin kombëtar si kondom, për asgjë tjetër! Shkatërrues të shtetit dhe çdo gjëje njerëzore dhe kombëtare, bashkë me presidenten e Ukrainës, Vojsa Osmani që nuk po lë gjë pa bërë edhe për një mandat. Edhe një mandat si presidente, phu, phu, estakfurullah siç thotëShefq.

Mijëra kopje të gazetës “Koha për Prishtinën” shpërndahen në lagjet e kryeqytetit

PRISHTINË, 25 GUSHT - Kandidati i PDK-së, për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka sjellë rikthimin e gazetës së shtypur në kryeqytet, shumë vite pas ndërprerjes së botimit të tyre. Pas paralajmërimit të bërë dje në rrjetet sociale, sot mijëra qytetarë u zgjuan me gazetën “Koha për Prishtinën” në duart e tyre. Gazeta do të botohet çdo javë

dhe përmban shkrime autoriale nga Ismaili dhe ekspertë të fushave të ndryshme, ku trajtohen problemet e përditshme të qytetarëve, potenciali i Prishtinës dhe zgjidhjet për një kryeqytet funksional. Ashtu si gazetat klasike, “Koha për Prishtinën” sjell rubrika me nostalgji, si fjalëkryqi dhe karikaturat, duke e rikthyer

traditën e leximit të shtypit të përjavshëm. Kjo gazetë do të shpërndahet falas për qytetarët në të gjitha lagjet e kryeqytetit.

Kjo nismë, sipas Ismailit, është një formë e re komunikimi dhe reflektimi, ku lidhja me qytetarët forcohet duke u ndalur te e kaluara, problemet e tashme dhe vizioni për të ardhmen e Prishtinës.



PROKURORIA KËRKON NJË MUAJ PARABURGIM PËR TË DYSHUARIN PËR SULM NDAJ PJESËTARËVE TË KFOR-IT

PRISHTINË, 25 GUSHT - Prokuroria Speciale e Kosovës i ka kërkuar të hënën Gjykatës Themelore në Prishtinë të urdhërojë një muaj paraburgim për një burrë të dyshuar për pjesëmarrje në sulmin e vitit 2023 kundër pjesëtarëve të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës në Zveçan.

I dyshuari, i identifikuar vetëm me inicialet Lj.M., u arrestua të dielën në Zveçan, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Prokuroria tha të hënën se “janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore” që i dyshuari të mbahet në paraburgim për 30 ditë.

Ai dyshohet se ka kryer katër vepra penale: bashkim për veprimtari kundërkushtetuese, rrezikim të personave nën mbrojtje ndërkombëtare, pjesëmarrje në turmë që kryen vepra penale dhe hulumtim dhe sulm ndaj personit zyrtar. “I pandehuri Lj.M., dyshohet se më 29.05.2023, para objektit të komunës së Zveçanit, në bashkëkryerje edhe me të dyshuar të tjerë ka sulmuar me gurë, bombë molotovi dhe armë pjesëtarët e KFOR-it, Policisë së Kosovës dhe gazetarët që kanë raportuar për ngjarjen”, thuhet në njoftimin e Prokurorisë.

Prokuroria shtoi se gjatë hetimeve dhe bastisjes në shtëpinë e të dyshuarit, ka gjetur prova materiale, si një telefon, uniforma të ndryshme ushtarake, dy USB, dhe një



fanellë me mbishkrim me motive nacionaliste, “me të cilat konfirmohen veprimet inkriminuese e të pandehurit në ditën kritike”.

Më 29 maj të vitit 2023, 93 pjesëtarë të KFOR-it kishin pësuar lëndime - disa prej tyre lëndime të rënda - pas përleshjes me protestuesit serbë. Të lënduar nga kjo

përplasje pati edhe në anën e protestuesve.

Dhunë në Zveçan shpërtheu pasi serbët lokalë kundërshtuan hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna të banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës, pas zgjedhjeve lokale të mbajtura më herët po

atë vit, që u bojkotuan nga serbët.

Deri tani, disa persona janë dënuar me burgim pas marrëveshjeve me prokurorinë për pranimin e fajësisë në lidhje me dhunën në Zveçan, ndërsa janë arrestuar dhjetëra të tjerë. Për dhunën në Zveçan, Kosova e ka fajësuar Serbinë, duke thënë se pas dhunës qëndruan “grupe

kriminale të afërta me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić.

Por, Beogradi e ka hedhur poshtë këtë akuzë, duke thënë se Qeveria e Kosovës po synonte që të shtynte serbët “drejt një konflikti të ri me NATO-n”. NATO-ja vazhdimisht ka kërkuar që autorët e dhunës të mbahen përgjegjës.

KLGI nis procesin e Auditimit Social me takimin e parë koordinues me organizatat partnere

PRISHTINË, 25 GUSHT - Në kuadër të projektit “Performanca Komunale drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm”, Instituti KLGI ka mbajtur takimin e parë koordinues me organizatat partnere lokale, të cilat do të angazhohen në zbatimin e Auditimit Social në nivel lokal. Ky takim kishte për qëllim të rrisë njohuritë e organizatave partnere mbi procesin e auditimit social, si dhe për koordinimin e agjendës së përbashkët për implementimin

e aktiviteteve të projektit.

Pjesëmarrësit patën mundësi të diskutojnë mbi rëndësinë e auditimit social si mekanizëm i fuqishëm për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në qeverisjen lokale, duke u fokusuar në praktikën më të mira dhe sfidat që mund të shfaqen gjatë zbatimit të procesit.

Këtë vit, Instituti KLGI do të realizojë procesin e Auditimit Social në gjashtë komuna: Junik, Klinë, Suharekë, Mitrovicë e

Jugut, Prizren dhe Partesh.

Në kuadër të këtyre komunave, do të auditohen gjithsej 17 projekte të financuara nga Granti i Performancës Komunale.

Ky proces pritet të kontribuojë drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të menaxhimit të fondeve publike dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje.

Ky projekt financohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL.



Jusaj viziton kompaninë "Muqa Solar", një model i suksesit në energjinë e ripërtëritshme

PRISHTINË, 25 GUSHT - Delegacioni, i përbërë nga kryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Kosovë, Shkëlzen Jusaj, anëtar i Bordit Miftar Veseli dhe drejtori i Zyrës në Kosovë Agim Kuleta, u prit nga pronari Xhevat Muqa dhe ekipi i tij profesional i "Muqa Solar". Gjatë takimit, u prezantua puna

dhe partneritetet ndërkombëtare të kompanisë, ndërsa Jusaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes bizneseve kosovare dhe atyre gjermane, si dhe investimeve në energjinë alternative.

Jusaj theksoi po ashtu që Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Kosovë do të mbështesë çdo iniciativë dhe

biznes që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe modernizimin e sektorit energjetik në Kosovë.

Vizitën e Unionit e vlerësoi kompania "Muqa Solar" si model frymëzues të inovacionit dhe qëndrueshmërisë, duke e cilësuar atë shembull për zhvillimin ekonomik dhe energjetik të Kosovës.



ATK-ja BËN THIRRJE QË TË DEKLAROHEN DHE TË PAGUHEN TATIMET PËR TË ARDHURAT E REALIZUARA SI: 'FREELANCER', 'INFLUENCER', 'OUT-SOURCE'

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 GUSHT - Administrata Tatimore e Kosovës ua rikujton të gjithë personave të cilët ofrojnë shërbime si "freelancer", "influencer", "out-source" etj., se janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat, të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e realizuara dhe nuk paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale. "Të gjithë personat të cilët krijojnë të ardhura në Kosovë dhe jashtë Kosovës nga aktiviteti i tyre si 'freelancer', 'influencer', 'out-source' etj., janë të obliguar të deklarojnë dhe paguajnë tatimet sipas rregullave mbi objektin e tatimit bazuar në legjislacionin tatimor të Kosovës në fuqi. Kur shërbimi si 'freelancer', 'influencer', 'out-source' etj., ofrohet si i punësuar, të ardhurat nga paga i nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim nga punëdhënësi vendor, ndërsa nëse i punësuar gjendet në Kosovë dhe punëdhënësi jashtë Kosovës, atëherë personi përfitues obligohet që individualisht të bëjë pagesën e tatimit dhe kontributit pensional", ka njoftuar ATK-ja.

Sipas ATK-së, deklarimi dhe pagesa e tatimit për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti "freelancer", "influencer", "out-



source" etj. bëhet përmes Sistemit Elektronik EDI, në periudhë vjetore apo mujore, varësisht nga zgjedhja që bën personi. "Nëse personi (i punësuar) zgjedh të deklarojë dhe paguaj tatimin me deklaratë vjetore, deklarimi dhe pagesa e tatimit bëhet nga data 01.01. deri 31.03. të vitit vijues për vitin paraprak, ndërsa kur personi (i punësuar) zgjedh të deklarojë dhe paguaj tatimin në periudhë mujore, deklarimi dhe pagesa e

tatimit bëhet nga data 01 deri 15 të muajit pasues për muajin paraprak. Kur shërbimet e ofruara si 'freelancer', 'influencer', 'out-source' etj., konsiderohen aktivitete ekonomike të pavarura, aktiviteti i tillë kërkohet të regjistrohet përmes ARBK-së dhe për të ardhurat e krijuara si biznes i regjistruar në Kosovë, deklarimi dhe pagesa e tatimit i nënshtrohet rregullave për pagesë si të ardhura nga shërbimet me normën 9% në

qarkullimin bruto apo sipas rregullave ligjore për të ardhura reale. Gjithashtu, të ardhurat nga aktiviteti ekonomik duhet të trajtohen sipas rregullave ligjore edhe për qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)", ka njoftuar ATK-ja.

Administrata Tatimore e Kosovës ka inkurajuar të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK-ja, do të detyrohet që të ndërmarrë

masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor. "Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare, siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore", ka njoftuar ATK-ja.

Hoti: Mbi 600 milionë euro janë projekte të BE-së të pezulluara për Kosovën


PRISHTINË, 25 GUSHT - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se 613.4 milionë euro është kostoja totale e masave të BE-së ndaj Kosovës për periudhën qershor 2023 - prill 2025.

Në një postim në "Facebook", ai ka thënë se këtu përfshihen

projektet e pezulluara për afat të pacaktuar. "Nga kjo shumë, 7.1 milionë euro janë të humbura plotësisht, të cilat parashiheshin për bujqësi, turizëm rural, ndërmarrje etj. Sektorët më së shumti të ndikuar janë: mjedisi 351 milionë euro, energjia 114

milionë euro, digjitalizimi 57 milionë euro, kultura 15 milionë euro etj", ka shkruar Hoti.

I njëjti pohoi se si burim për këto ka GAP-in, me hulumtimin "Ndikimi financiar i masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës".



JEAN-CLAUDE TRICHET I ALARMUAR: BE-ja ËSHTË NJË XHUXH MES SHBA-ve DHE KINËS

“Bota ka ndryshuar që kur presidenti i Shteteve të Bashkuara vendosi të imponojë ligjin e më të fortit. Mënyra e vetme që ne evropianët të reagojmë është të promovojmë zbatimin e projektit federal, dhe nuk mund të jemi pesimistë për këtë qëllim”.

Kështu ka deklaruar ish-presidenti i Bankës Qendrore Evropiane, Jean-Claude Trichet, i cili shpreh shqetësim për dobësinë politike të Bashkimit Evropian përballë sfidave globale. Në një analizë të fundit, ekonomisti francez dhe paraardhësi i Mario Draghi-t në Bankën Qendrore evropiane, thekson nevojën urgjente për thellimin e integritimit evropian dhe ndërtimin e një federate të vërtetë politike.

Ashtu si Draghi, “me të cilin ndaj përfundimet e raportit, besoj se Evropa duhet të ecë përpara në procesin e integritimit”.

Ai shton se Evropa ndodhet mes dy forcave destabilizuese: “Kemi një autokrat agresiv rus dhe një president amerikan që dëshiron të na braktisë në fatin tonë, megjithatë besoj se pikërisht nga bashkimi i këtyre dy forcave negative do të lindë vendosmëria e Evropës për të realizuar gradualisht projektin e saj afatgjatë, i cili duhet të jetë ai i një federate të vërtetë politike. Do t’ia dalim”.

Ekonomia është paralizuar nga zgjedhjet e Trump-it. Presidenti i Fed-it, Jerome Powell, dha miratimin për një ulje të parë të normave të interesit: A është ky fillimi i një trendi?

“Le të shohim anët pozitive: Powell ka riafirmuar pavarësinë e bankave qendrore duke rezistuar ndaj sulmeve verbale të paprecedenta nga



administrata amerikane. Dhe ky është thelbi. Tani ai mendon, duke u bazuar vetëm në të dhëna, veçanërisht ato negative për punësimin që dolën menjëherë pas mbledhjes së fundit të Fed-it, se ka ardhur momenti për një ulje të moderuar të normave në mbledhjen e ardhshme të shtatorit. E kam vlerësuar shumë faktin që Powell konfirmoi synimin për të mbajtur pritshmëritë për inflacionin të ankoruara fort rreth 2% në afat të mesëm. BQE është në të njëjtën linjë. Në mënyrë të qëndrueshme, zhvillimet e ardhshme të politikës monetare do të varen nga të dhëna të reja, të cilat mbeten kryesisht të paparashikueshme për shkak të ndikimit të ardhshëm të

vendimeve të administratës aktuale amerikane për tarifatat doganore, emigracionin dhe politikën buxhetore”.

Por si mund të mbrohet Evropa nëse aleati historik i kthehet kundër?

“Strategjia e vetme e mundshme është të përshejtojmë ndërtimin e projektit federal. Ekonomia është thelbësore. Duhet të përfundojmë shpejt tregun unik për bankat dhe kapitalet: BE-ja është një xhuxh financiar krahasuar me Shtetet e Bashkuara dhe Kinën. Nevojitet një treg i vetëm për platformat dixhitale, telekomunikacionin, industrinë e armëve, energjinë dhe sektorë të tjerë. Vetëm me një bashkim të vërtetë mund të

financohen investimet që nuk mund të shtyhen më. Tregu unik nuk mjafton, këtë e kemi parë qartë në diskutimet tregtare: partneri amerikan përfiton sidomos nga diplomacia e tij e unifikuar, mbrojtja unike, ekzekutivi i unifikuar. Në të gjitha negociatat, jo vetëm me Shtetet e Bashkuara, “tavani ynë i xhamtë” është se ende nuk kemi bërë një federatë e plotë”.

Në veçanti, për unionin bankar, a do të mjaftonte zgjidhja e pengesës për sigurimin e kursimeve të depozituesve?

“Jo, për fat të keq kjo është e nevojshme, por jo e mjaftueshme. Dhe kjo është e pashpjegueshme kur mendon se në disa sektorë industrialë ia kemi dalë: Airbus ka të njëjtën

peshë me Boeing në aviacionin civil, në industrinë e makinave janë realizuar bashkime gjigante. Në financë, përkundrazi, pengesat duken të pakapërcyeshme. Mund të projektojmë zgjidhjet teknike më të sofistikuara për të përfunduar unionin, dhe është absolutisht e nevojshme ta bëjmë këtë, por gjithmonë do të na duhet të kapërcejmë paragjykimet kombëtare, mungesën e besimit të ndërsjellë, rezistencat ndaj bashkimeve që mund të krijojnë në fund grupe evropiane mjaftueshëm të mëdha për të përballuar gjigantët amerikanë dhe kinezë. Përndryshe, do të jemi të dënuar përjetësisht të përjashtohemi nga gara botërore që po zhvillohet mes dy blloqeve të mëdha, Uashingtonit dhe Pekinit. Pika jonë e dobët është që nuk kemi një federatë”.

Realisht, sa shpresa duhet të kemi?

“Nuk jam naiv. Rruga drejt një federate të vërtetë është politikisht e vështirë në të gjitha vendet tona dhe do të jetë e gjatë. Por nuk besoj se Evropa mund të pranojë përgjithmonë të jetë një xhuxh politik që thjesht vështrojnë pasivisht negociatat mes gjigantëve – sot amerikanë, kinezë dhe rusë, nesër India, Pakistani, Brazili, Indonezia e me radhë, të gjitha federata politike. Situata aktuale, në të cilën Evropa neglizhohet nga Shtetet e Bashkuara në negociatat tregtare, përjashtohet nga negociatat për Ukrainën dhe nuk ka rol në Lindjen e Mesme, nuk mund të zgjasë përjetësisht”.

“La Repubblica”

GJERMANIA NDESHET ME KRIZËN E PENSIONEVE: A MUND TA NDRYSHOJNË 10 EURO NË MUAJ MËNYRËN SI INVESTOJNË NJERËZIT?

Kancelari gjerman Friedrich Merz ka nxitur të rinjtë që të mos mbështeten vetëm tek pensionet shtetërore, por të investojnë rregullisht shuma të vogla në tregun e aksioneve, një nismë që ka nxitur reagime të ashpra nga sindikatat. Sindikata e fuqishme IG Metall e ka quajtur këtë qasje “të ndarë nga realiteti dhe të rrezikshme”, duke kërkuar përforcimin e sistemit publik të pensioneve.

Sistemi publik gjerman i pensioneve, themeluar nga Otto von Bismarck në 1889, po përballlet me sfida të mëdha për shkak të plakjes dhe zvogëlimit të fuqisë punëtore: Deri në vitin 2036, 19.5 milionë gjermanë do të jenë pensionuar, ndërsa vetëm 12.5 milionë punonjës të rinj do t’i

bashkohen tregut të punës. Qeveria aktuale synon të inkurajojë kursimet private të pensioneve përmes llogarive individuale me bazë kapitali, duke nisur një subvencion të ri prej 10 eurosh në muaj për fëmijët nga 6 deri në 18 vjeç, që do të investohen në një plan aksionesh dhe do të mbahen deri në moshën e pensionit. Ekspertët paralajmërojnë se efekti real ekonomik mund të jetë modest, por qëllimi është ndryshimi i sjelljes financiare të familjeve dhe të rinjve për të rritur ndërgjegjësimin për investimet.

Për shumë gjermanë, investimet në aksione mbeten të panjohura: Vetëm 17% e popullsisë posedon aksione ose fonde investimi, krahasuar



me 39% në Mbretërinë e Bashkuar dhe 62% në SHBA. Sipas profesorëve të financave, përfitimet më të mëdha priten nga përvoja praktike dhe kultura e kursimeve të kapitalit, jo vetëm nga

subvencionet simbolike. Historikisht, tentativat për të promovuar pensionet private kanë dështuar. Shembuj janë produktet si Riester Pension, të cilat shpesh kanë rezultuar të shtrenjta dhe me kthime të

ulëta. Merz dhe këshilltarët e tij shpresojnë që nisma e re, duke filluar nga një investim i vogël mujor prej 10 eurosh, mund të krijojë një efekt afatgjatë duke nxitur të rinjtë të investojnë më shumë dhe të ndërgjegjësojnë familjet për sigurinë financiare në të ardhmen.

Sipas llogaritjeve, me një kthim mesatar vjetor prej 7%, një investim prej 10 eurosh në muaj për fëmijët mund të rritet në rreth 65,000 euro në 50 vjet, megjithëse inflacioni mund të zvogëlojë vlerën reale. Megjithatë, ekspertët theksojnë se përfitimet më të mëdha janë psikologjike dhe kulturore, duke ndikuar tek mënyra se si gjermanët menaxhojnë kursimet dhe investimet gjatë dekadave të ardhshme.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Donjeta Sadiku në përgatitje intensive për Botërorin e boksit

Nga data 13 gusht deri më 2 shtator, boksierja Donjeta Sadiku bashkë me trajneren dhe selektoren Marjola Sallauka po marrin pjesë në kampin elitare stërvitor në Sheffield të Anglisë, aty ku po përgatiten boksierët më të

mirë të botës. Nga ky kamp është një hap i madh drejt Kampionatit Botëror 2025, që do të mbahet nga 4-14 shtator në Liverpool. Sadiku tashmë ka dëshmuar veten si një prej boksierëve më të mira të botës, duke fituar medaljen e bronzitë

në Kampionatin Botëror 2022 në Stamboll, medaljen e bronzitë në kampionatin Evropian 2022 në Budva. Këtë vit ajo shkëlqeu në turnet më të mëdhenjë botëror në Strandja në Bullgari, në Brussels Capital Tournament në Belgjikë dhe

Kupën Botërore në Feliks Stamm në Varshavë, duke fituar medaljet e arta nga të tre turnetë. Tani besimi dhe shpresa janë që nga ky kampionat, Donjeta të sjellë në Kosovë medaljen e artë, titullin kampione e botës.



‘YLLI I JAVËS’ NË SUPERLIGË: PEFQELI: ÇMIMIN IA DEDIKOI BABAIT TË NDJERË

“Epoka e re”

PRISHTINË, 25 GUSHT - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të ndajnë çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim, për javën e dytë në Albi Mall Superligë, i është ndarë futbollistit të KF Dukagjinit, Mërgim Pefqeli. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Vllaznim Visoka, Xhavit Mehmeti dhe Enver Prapashtica. Ky komision vendosi që çmimi “Ylli i javës” për xhiron e dytë në këtë edicion kampional t’i takojë Mërgim Pefqelit, i cili shënoi një nga golat në ndeshjen kundër SC Gjilani (2:0), duke qenë një nga lojtarët më të vlefshëm të ekipit të tij në arkëtimin e 3 pikëve nga klinasit. Pasi mori këtë çmim, Pefqeli u shpreh i lumtur që u vlerësua si lojtar i mirë i javës: “Falënderoj stafin e klubit që u angazhuan gjatë gjithë javës me taktikat dhe përgatitjen e lojës për ta mundur Gjilantin. Gjithçka që kemi punuar gjatë javës ishte shumë efektive në ndeshje dhe kjo ka qenë pika kryesore në fitoren ndaj Gjilanit”. “Gjatë verës kemi pasur disa transfere, si Merisin i cili ka përfunduar gjithë fazën përgatitore me ne,



së fundi na është bashkuar edhe Zulfija, por është komponuar shumë mirë me ekipin dhe ishte ai i cili shënoi gol në ndeshjen kundër Gjilanit. Besoj që këto transfere na bëjnë ekip shumë më të fortë, meqë na pret një kampionat i gjatë dhe i rëndë, duhet të kemi më shumë lojtarë dhe të jemi kompaktë. Falënderoj të gjithë bashkëlojtarët dhe stafin teknik që më ndihmuan të shënoj gol. Këtë gol, fitoren dhe çmimin ‘Ylli i javës’ ia dedikoj babit tim të ndjerë i cili kishte ditëlindjen”, ka deklaruar ai për faqen zyrtare të FFK-së. Çmimit

për futbollistin e javës në Superligë i është gëzuar edhe skuadra e Mërgim Pefqelit, Dukagjini nga Klina. “KF Dukagjini është krenar të njoftojë se futbollisti ynë, Mërgim Pefqeli, është shpallur ‘Ylli i Javës’ në xhiron e dytë të Albi Mall Superligës së Kosovës. Ky vlerësim nga Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vjen si rezultat i paraqitjes së shkëlqyer të Pefqelit në fitoren tonë 2:0 ndaj SC Gjilanit, ku ai shënoi njërin prej golave. Përgëzime Mërgim!”, thuhet në postimin e Dukagjinit.

Shkurt

Fisnik Rugova largohet nga Prishtina

Basketbollisti Fisnik Rugova nuk do të jetë pjesë e Sigal Prishtinës për sezonin e ri në Superligën e Kosovës në basketboll. Rugova ka falënderuar klubin për gjithçka, duke bërë me dije se do ta vazhdojë karrierën diku tjetër. Duket se Prishtina dhe Rugova, i cili ishte kapiten sezonin e shkuar nuk kanë arritur marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimi. Rugova është zhvilluar si basketbollist te Prishtina, ndërsa gjatë karrierës ka luajtur edhe për Pejë, Rahovecin e Bashkimin. Rugova i gjatë 206 centimetra luan krah-qendër dhe sezonin e fundit ka pasur një mesatare prej 3 pikëve e po aq kërcimeve për ndeshje.

Trajneri i Lille: Zhegrova është këtu, nuk e di nëse do jetë deri në fund

Telenovela Edon Zhegrova akoma nuk po gjënë përfundim. Futbollisti nga Kosova po kërkohet me ngulm nga Marseille dhe Juventus, mirëpo Lille nuk po bindet nga ofertat ekonomike të këtyre ekipeve dhe nuk po lëviz nga pretendimet e tyre. Në këtë formë probleme të vazhdueshme po ka edhe trajneri Bruno Genesio, i cili vazhdimisht po pyetet nga gazetarët në lidhje me çështjen Zhegrova. Ai edhe pas fitores 1:0 ndaj Monaco me një gol të minutave të fundit foli për sulmuesin e krahut. “Ai është këtu me ne. Do e shohim nëse do qëndroj deri në fund. Edoni ka nevojë për kohë, pasi nuk ka luajtur që një kohë të gjatë. Ka pasur probleme dhe lodhje në muskuj gjatë pasdites, kjo është një prej arsyeve që nuk luajti”, ishin disa prej fjalëve të trajnerit.

FShF-ja nxjerrë në shitje biletat fizike për Letoninë

Federata Shqiptare e Futbollit (FShF), ka njoftuar se kanë dalë në shitje biletat fizike për ndeshjen kundër Letonisë. Përballja Shqipëri - Letoni, luhet më 9 shtator në stadiumin “Air Albania” në Tiranë dhe i takon kualifikimeve për Botërorin 2026. FShF-ja ka shkruar se të gjithë “futbolldashësit dhe tifozët e Kombëtares kanë mundësi ti blejnë biletat edhe fizikisht për këtë ndeshje”. Biletat mund të sigurohen në pikën e shitjes që ndodhet në stadiumin “Air Albania”, e cila do të jetë e hapur çdo ditë prej orës 10:00 deri në orën 18:00. Këtë vendim, FShF e ka marrë shkaku i kërkesave të vazhdueshme të tifozëve për bileta fizike dhe në të njëjtën kohë vazhdon edhe shitje online e biletave për këtë ndeshje. Selektori i Shqipërisë, Sylvinho pritet që gjatë kësaj jave ta bëjë publike listën e futbollistëve të ftuar për ndeshjet e muajit shtator. Katër ditë para duelit me Letoninë, Shqipëria do të luajë ndeshjen miqësore ndaj Gjibraltarit.

Zyrtare: Kristjan Asllani, lojtari më i ri i Torinos

TORINO, 25 GUSHT - Kristjan Asllani është zyrtarisht futbollist i ri i Torinos. Reprezentuesi shqiptar u transferua nga Interi në huazim me pagesë prej 1.5 milionë eurosh me të drejtë blerjeje të përcaktuar në 12 milionë euro. Asllani pasi kreu vizitat mjekësore të zakonshme dhe

nënshkroi kontratën që do ta lidhë me Torinon që nga e enjtja, u zyrtarizua sot nga klubi për shkak të disa problemeve burokratike mes klubit dhe Interit. Klubi zikaltër dërgoi me vonesë në Torino dokumentet e nevojshme për të kompletuar regjistrimin e mesfushorit

organizator të lindur në vitin 2002, në mënyrë që ai të mos ishte i grumbullueshëm për ndeshjen e mbrëmjes së sotme pikërisht kundër ish-ekipit të tij. Asllani është përforcimi i shtatë i klubit të Torinos dhe i shtohet blerjeve të tjera verore të Torinos, si Anjorin, Ngonge, Ismajli, Aboukhlal, Israel

dhe Simeone. Në korrik të 2022, ai u bashkua me Interin, ku në tri vite si pjesë e “Nerazzurrëve”, ai bëri 99 paraqitje, duke shënuar katër gola dhe duke dhënë pesë asistime. Kabineti i tij personal i trofeve përfshin një Scudetto, një Kupë të Italisë dhe dy Superkupa të Italisë.



Saka mungon një muaj

LONDËR, 25 GUSHT - Arsenali po përballët sërish me probleme të mëdha nga dëmtimet. Pas Kai Havertz, i cili do të mungojë për disa javë për shkak të një dëmtimi në gju, tani është Bukayo Saka që i shtohet listës së të padisponueshmëve. Ylli

anglez u detyrua të largohej nga fusha në minutën e 53-të të fitores 5-0 kundër Leeds-it, vetëm pak minuta pasi kishte shënuar golin e dytë të ndeshjes për “Topçinjtë”. Analizat mjekësore kanë konfirmuar një dëmtim në bicepsin femoral, i cili pritet

ta mbajë jashtë për rreth një muaj. Ky problem fizik do ta bëjë Sakan të humbasë supersfidën ndaj Liverpoolit në “Anfield”, të dielën, si edhe dy ndeshjet e Anglisë për kualifikueset e Botërorit: më 6 shtator kundër Andorrës dhe më 9 shtator

ndaj Serbisë. Kujtojmë se sezoni i kaluar nuk ishte i lehtë për 23-vjeçarin, i cili humbi tre muaj të rëndësishëm pikërisht për një dëmtim të ngjashëm në bicepsin femoral. Tashmë, rikuperimi i tij do të jetë përsëri në fokusin e stafit



mjekësor të Arsenalit dhe të kombëtares angleze.

Lëndimi i Ter Stegen hap derën për rikthimin e Neuerit

BERLIN, 25 GUSHT - Lëndimi në shpinë i Marc-Andre ter Stegen (33-vjeçar) do ta mbajë jashtë fushave për disa muaj dhe në Gjermani ekziston frikë se gjendja e tij fizike mund të bëhet problem në prag të Kupës së Botës së verës së ardhshme. Trajneri i kombëtares, Julian Nagelsmann, pas operacionit të portierit të Barcelonës ka theksuar: “Duhet të jetë numri 1 në klubin e tij që të luajë titullar në Botëror”. Duke rihapur kështu diskutimin për një rikthim të Manuel Neuer. Ky i fundit verën e kaluar shpalli tërheqjen nga kombëtarja pas 15 vitesh si titullar i padiskutueshëm. Skenari i një rikthimi të Neuer nuk përjashtohet më dhe po shihet gjithnjë e më shumë si opsion serioz. Hermann Gerland, trajner i njohur dhe ish-asistent i Bayernit për shumë vite, në një intervistë për ZDF ka thënë se rikthimi i Neuer është zgjidhja më e mirë: “Manuel Neuer do të luajë edhe disa vite. Dhe nëse



Gjermania do të arrijë diçka, Nagelsmann duhet të aktivizojë më të mirin. Ai është Neuer”. Gerland gjithashtu lavdëroi Hansi Flick-un, me të cilin punoi te Bayerni (2019-2021) dhe më pas në kombëtare si skaut: “Hansi ishte fantastik, si profesionalisht ashtu edhe si njeri. Trajtonte këdo

me respekt, shpjegonte pse dikush nuk luante dhe mbetet në nivelin më të lartë”. Tekniku zbuloi edhe një ftesë të Flick për të vizituar Barcelonën dhe La Masia, por shtoi me humor: “Pas 55 vitesh në bankina, kam kursyer pak, ndaj mund ta paguaj vetë udhëtimin”.

Verstappen: Qëllimi është ta mbyllim sezonin me dinjitet

MILTON KEYNES, 25 GUSHT - Rezultatet zhgënjyese të kohëve të fundit, me katër gara radhazi jashtë podiumit, i kanë shkatërruar përfundimisht ambiciet e Max Verstappen për titullin e pestë kampion bote për pilotë në Formula 1. Kampioni i Red Bull, pas muajsh spekulimesh dhe flirtesh me Mercedes, ka vendosur të qëndrojë në Milton Keynes pavarësisht pasigurive. Këto nuk lidhen vetëm me situatën aktuale zhgënjyese teknike të makinës (RB21 është e treta ose edhe e katërta më e shpejtë në pistë), por edhe me dyshimet rreth njësisë së fuqisë Red Bull-Ford që do të debutojë sezonin e ardhshëm, e cila sigurisht nuk konsiderohet aktualisht ndër favoritet për epokën e re rregullatore.



Megjithatë, është ende gjysma e dytë e sezonit për t’u zhvilluar, duhen rezultate për të mbajtur moralin lart dhe shmangur kështu një thatësi të gjatë podiumesh dhe fitoresh. “Qëllimi është gjithmonë të përfundojmë me dinjitet edhe pse të gjithë janë tashmë të përqendruar te viti 2026”, ka thënë Max Verstappen. “Ajo që duam tani është të

përiqemi të arrijmë një makinë të ekuilibruar dhe në fund të fundit, rezultate më të qëndrueshme. Nuk e di nëse do të jetë e mundur të fitojmë përsëri dhe pas një fundjave si ajo në Hungari (ku ai përfundoi i nënti), është shumë e vështirë të thuhet. Por nuk i dihet kurrë, dhe mund të ketë ende surpriza”, ka deklaruar holandezi. “Unë thjesht qëndroj neutral për gjithçka dhe kështu nuk bëhem tepër optimist ose pesimist. Para vitit 2025, mendoja, ‘Epo, do ta shohim’. Sigurisht, shpresoj që ende të mund të fitojmë disa gara këtu e atje. Dhe ia dolëm, fituam dy, por është ende e vështirë. Nga ana tjetër, duhet ta pranosh që McLaren bëri një punë të shkëlqyer nga viti i kaluar deri në këtë vit”, ka deklaruar Verstappen.

SHKURT

De Bruyne: Ende me duhet të përshtatem në Seria A

Aventura e Kevin De Bruyne me fanellën e Napoli në Serie A nisi me një gol në fitoren 2-0 ndaj Sassuolo. Lojtari belg ka mbetur i kënaqur nga rezultati dhe goli shënuar pas një krosimi në zonë, top që nuk u prek nga askush. “Çfarë mendova kur pashë topin të hynte në portë? Ishte mirë të filloja kështu, me një gol dhe fitore. Unë doja ta vendosja topin në një zonë rreziku, dhe për fat të mirë askush nuk e preku dhe ai hyri në portë”, ka thënë De Bruyne. “Mënyra se si po punoj në Itali është shumë e ndryshme, por unë jam ai që duhet të përshtatet. Gjithsesi, ne mund të kishim bërë edhe më mirë në këtë ndeshje të parë, duhet të vazhdojmë të punojmë për të përsëritur atë që ndodhi vitin e kaluar”, ka deklaruar belgu.

Alonso: Mbappe rifitoi katër kilogramet që humbi në Botërorin e Klubeve

Real Madridi e mori fitoren e dytë radhazi në La Liga dhe pas sfidës kundër Real Oviedos, foli trajneri Xabi Alonso. “Mendoj se ishim shumë të mirë. Dominuam me shumë pjesën e parë, luftuam pak më shumë në të dytën, por luajtëm mirë në mbrojtje. Po përmirësohemi dhe jam i lumtur”, ka thënë Alonso, i cili foli edhe për Kylian Mbappe. “Ai ka shtuar katër kilogramë. Ai humbi katër në Kupën e Botës. Ai po luan mirë, më pëlqen ta shoh të luajë kështu. Ai luajti shumë mirë sot, dhe ndeshjen e parë gjithashtu. Ne ende po vlerësojmë se çfarë duhet të rregullohet, por ndjenja është e mirë”, ka deklaruar Alonso.

Nottinghami synon ta rikthejë Mourinhon në Premier Ligë

Një rikthim sensacional në Premier Ligë është i mundur për Jose Mourinho, aktualisht në krye të klubit turk Fenerbahçe. Pas Chelsea (dy herë), Manchester United dhe Tottenham, trajneri portugez është favoriti për të marrë drejtimin e Nottingham Forest. Pavarësisht se u kualifikua për Ligën e Evropës sezonin e kaluar dhe bëri një debutim fitues javën e kaluar, pronarët e klubit anglez duket se janë të vendosur ta shkarkojnë trajnerin Nuno Espirito Santo, i cili ka kritikuar afatin kalimtar të verës. “Gjithmonë kam pasur një marrëdhënie të shkëlqyer me presidentin. Kemi folur çdo ditë në muajt e fundit, por gjërat nuk kanë shkuar aq mirë kohët e fundit”, ka thënë Nuno Espirito Santo, që ka shtuar: “Jemi prapa në merkato dhe jam i shqetësuar për sezonin që sapo ka filluar”. Sipas mediave britanike, shkarkimi i trajnerit portugez tani është çështje ditësh, pas të cilave do të jetë radha e Jose Mourinho, i cili tashmë ka shprehur gatishmërinë e tij në parim për t’u transferuar nga Stambolli në Nottingham.

Wolff: Horner është sjellë shumë herë si idiot

Nuk ishte sekret që Toto Wolff dhe Christian Horner nuk ishin miq të mëdhenj, por shefi i Mercedesit nuk e kurseu gjuhën kur kujtoi periudhën e Hornerit te Red Bull-i, skuadër që britaniku e drejtoi për më shumë se dy dekada. “Gjatë 12 deri në 15

vitet e fundit, ai është sjellë shpesh si një idiot. U udhëhoq nga vlera krejtësisht të ndryshme, por edhe armiku ynë më i madh ka një mik të ngushtë”, u shpreh Wolff, duke njohur gjithashtu meritën e rivalit të tij: “Nga ana tjetër, ai arriti

një sukses të jashtëzakonshëm në atë që bënte. Tani që është larguar, të paktën për një periudhë kohe, të gjithë jemi të vetëdijshëm se një personalitet i vërtetë ka lënë sportin”. Austriaku madje bëri shaka me mungesën e

Hornerit në paddock: “Ai gjithmonë thoshte se unë e doja që ta urreja. Po tani, kë do të urrej? Duhet të gjej dikë tjetër...”. Deklaratat e Wolff vijnë vetëm disa javë pasi Zak Brown, shefi i McLaren, pranoi se, pa Horner, si Formula 1 ashtu

edhe mbledhjet mes drejtuesve janë “më të shëndetshme”. Horner u shkarkua nga Red Bull-i pak ditë pas Çmimit të Madh të Britanisë, pas më shumë se 20 vitesh në krye të ekipit, duke u zëvendësuar nga Laurent Mekies.



Prishtinë 10000 Kosovë. Rruga "TIRANA" nr. 125 Tel. +383 (0) 38 613 026

Nr. i protokolit: 429
Data: 25.08.2025

Bazuar në nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/1 – 138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L – 143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe në bazë të rregullores (MASHT) nr. 01/2017, të datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave nga aftësimi profesional dhe arsimit për të rritur, rregulloren për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimi profesional dhe arsimit për të rritur, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) për vijimin e mësimi për të rritur në Qendrën e Kompetencës “SHTJEFËN GJEÇOVI” në Prishtinë, për vitin shkollor 2025/2026, afati i Janarit

në këto profile:

- Dirigjimi kompjuterik i makinave
- Metalpunues
- Automekanik
- Mekatronikë
- Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ngrohjes dhe klimatizimit
- Operator Prodhimi
- Floktari
- Konfeksioner
- Rrobaqepës
- Transport rrugor
- Trafik rrugor
- Transpor hekurudhor (Drejtues i trenave, Lëvizje e trenave, Tërheqje e trenave).

KUSHTET:

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimit për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L – 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 ; UA 12/2014, i datës 05.05.2014, dhe UA 13/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit- kandidatët të cilët kanë moshën mbi 17 vjetë.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Dëftesa e klasëve të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- a) Për regjistrim të vitit për një klasë100,00 €
- b) Për praktikë profesionale50,00 €
- c) Për provim diferencial 10,00 €
- d) Provimi përfundimtar /certifikata – diploma50,00 €

Pagesat bëhen në institucionet financiare sipas kodit të shkollës.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin “Arsimi dhe aftësimi për të rritur” janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Thirrje për aplikim

BES-JET SHPK., NUI 811498345, po kërkon ofertues/ wkontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

Ndërtimi i serrës me sipërfaqe 0.42 ha (0.25 ha dhe 0.17 ha)

Nr. Prokurimit 001/25 - BES-JET SHPK

Emri: BES-JET SHPK

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit:

besarkryeziu4@gmail.com, Adresa: NEPERBISHT, SUHAREKE, Tel: 049/474475

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 10 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 15:00, në Adresë: BES-JET SHPK, NEPERBISHT, SUHAREKE.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valentina Kaçuri shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I. II. III të shkollës së mesme “7 Shtatori” Prishtinë.
- Burhan Qajani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme " Dardania " Hani Elezit.
- Kemuran Qajani Qajani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Dardania" Hani Elezit.
- Burimi sh.p.k. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit 811919466 të lëshuar në Prishtinë.
- Bedrije Bejtullahu shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I,II,III,IV si dhe diplomën e shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Fadil Statovci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Eqrem Çabej” Prishtinë.
- Jeta Hasimja shpall të pavlefshme dëftesat ekl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Arlind Popaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Liria” Bellacërk Rahovec nga kl. 1-9.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitij, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

